

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41./2014, 53/ 16 dhe 83/18), dhe duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga Eduard Kettner GmbH, me adresë në Kaplan Allee nr.5, 7025 Pottelsdorf, Austri, përmes Andrea Lazarevska, avokate nga Shkupi, në seancën mbajtur më 06.09.2023, solli

AKTVENDIM

Vërtetohet se përqendrimi me të cilin Eduard Kettner GmbH, me adresë në Kaplan Allee nr.5, 7025 Pottelsdorf, do të fitoj kontrollin mbi shoqërinë Frovis GmbH, me adresë në Studa 12, 6800 Feldkirh, Austri, nëpërmjet shitblerjes së aksioneve, edhe pse është në kuadër të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore, sidomos si rezultat i formimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe si i tillë **është në përputhje me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.**

Parashtruesi i njoftimit të përqendrimit obligohet të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumën prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për taksë administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbardimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje me nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës më 18.06.2023, e plotësuar më 21.08.2023, është dorëzuar njoftim për përqendrim nga Eduard Kettner GmbH, me adresë Kaplan Allee Nr. 5, 7025 Pottelsdorf, Austri, me anë të të cilit Eduard Kettner GmbH do të fitoj kontrollin mbi shoqërinë Frovis GmbH, me adresë Studa 12, 6800 Feldkirh, Austri, nëpërmjet shitblerjes së aksioneve.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin e Përqendrimit, shtesave dhe bashkëngjitjeve në të, përcaktoi si më poshtë:

Aktivitetet themelore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:

Eduard Kettner GmbH është një shitës me pakicë i pajisjeve të gjuetisë, veshjeve të jashtme dhe armëve jo-ushtarake. Ai operon në disa lokacione në Austri. Eduard Kettner GmbH nuk ka ndërmarrje-

bijë ,filiale, zyra përfaqësuese ose aktivitete në Maqedoninë e Veriut dhe nuk ka bërë shitje për klientët në Maqedoninë e Veriut në vitin 2022. Eduard Kettner GmbH është pjesë e grupit SIH, i cili ka një ndërmarrje- bijë të inkuorporuar në Maqedoninë e Veriut, BAUMIT d.o.o. Shkup, aktiv në furnizimin e produkteve BAUMIT si suva të thata, sisteme fasadash, pllaka izoluese dhe sistem kompozitor për termoizolim të jashtëm.

Frovis GmbH është një shoqëri e specializuar në armët sportive. Frovis GmbH operon një lokacion në Forarlberg, një provincë austriake. Prodhon, riparon dhe bën shërbim të mirëmbajtjes(servis) të armëve të gjuetisë dhe sportive.

Frovis GmbH nuk ka ndërmarrje-bijë, filiale, zyra përfaqësuese apo aktivitete në Maqedoninë e Veriut dhe nuk ka bërë shitje për klientët në Maqedoninë e Veriut në vitin 2022.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës*, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij , veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

KRYETAR
I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS
Prof. Dr. Владимир Наумовски

